



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1726 Prot.

Tiranë, më datë 20.12.2021

VENDIM
Nr. 690, datë 20.12.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 20.12.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e Konceptit të Sondazheve Arkeologjike i realizuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Taulant Rama, në kuadër të projektit “Rikonstruksion me shtim volumi (Shtesë 1 kat & shtesë anësore 2 Kat + 1 kat nëntokë në objektin ekzistues 2 Kat) dhe Riparim i Rrethimit”, Lagja 10, Rruga “Eleni Dasho”, Brenda kufirit të Zonës Arkeologjike B të qytetit të Durrësit, me aplikues “JF Architectural Designer” sh.p.k. dhe zhvillues z. Lulzim Kardhiqi;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhin arkeologjik në kuadër të projektit me objekt “Rikonstruksion me shtim volumi (Shtesë 1 kat & shtesë anësore 2 Kat + 1 kat nëntokë në objektin ekzistues 2 Kat) dhe Riparim i Rrethimit”, Lagja 10, Rruga “Eleni Dasho”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

